



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 985/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, rruga “Armend Daci” nr.1, Prishtinë, kundër debitorit “Graniti 1” SH.P.K., me NRB: 810976102, me seli në Landovicë, Prizren, përfaqësuar nga pronari N.K., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.168/23 të datës 01.06.2023, të Përmbartuesit Privat Mehdi S.Reshani, me seli në Prizren, jashtë seancës me datën 20.09.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Graniti 1” SH.P.K., i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.168/23 të datës 01.06.2023, të Përmbartuesit Privat Mehdi S.Reshani.
- II. MBETET NË FUQI urdhri përmbartimor P.nr.168/23 i datës 01.06.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi S.Reshani.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Mehdi S.Reshani, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.168/23 të datës 01.06.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor Aktvendimit të Komisionit i Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr.232 të datës 03.02.2021, me të cilën është urdhëruar debitori që t’ia paguaj kreditorit në emër të gjobës administrative shumë prej 5,000.00 €, si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe bartjen e shumës përkatëse në xhirrollogarinë bankare të kreditorit, në të kundërtën përmbartimi të realizohet me

ndalim, sekuestrimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare duke përfshirë rrjedhën e interesit, regjistrimin, sekuestrimin dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe nga shitja e këtyre të realizohet borxhi ndaj kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se, urdhri i përmbaresit privat është në kundërshtim me dispozitat themelore të procedurës përmbaremore dhe asaj kontestimore, sepse si i tillë nuk është i kuptueshëm dhe në kundërshtim me vetveten dhe me arsyet e dhëna dhe si i tillë nuk mund të ekzaminohet. Ka theksuar se përmbareusi privat me ligj është i obliguar që së bashku me urdhrin debitorit ti dorëzoj edhe provat përkatëse në të cilat është mbështetur ky urdhër sipas propozimit të kreditorit. Debitori gjithashtu nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt as aktin administrativ nr. 5015 të datës 03.12.2020 as aktin administrativ nr.232 të datës 03.02.2021, pasi që asnjëri akt administrativ nuk i është dorëzuar personalisht debitorit dhe kreditorit nuk ka paraqitur asnjë provë me të cilën do të vërtetohet se debitori i ka pranuar aktet e përmendura. I ka propozuar gjykatës që të aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se prapësimin e debitorit e konsideron si të pa bazuar për shkak se i njëjti nuk përmban asnjë arsyetim të bazuar në fakte dhe prova për të cilat është paraparë në nenin 71 të LPP-së, i cili duhet të mbështetur me prova të duhura. Ka theksuar se sa i përket pretendimit të debitorit se urdhri përmbareimor i përmbaresit privat është në kundërshtim me dispozitat e procedurës përmbaremore pa e specifikuar se për cilat dispozita bëhet fjalë duke theksuar se nuk është e qartë se për cilin akt administrativ është fjala, nuk qëndron ngase akti administrativ nr.232 të datës 03.02.2021 i kreditorit është bërë i ekzekutueshëm në përputhje me nenin 14 par.1 nën para 1.1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Meqenëse debitori nuk ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të KPMM-së, si organ i shkallës së dytë, akti administrativ Nr.232 i datës 03.02.2021 është bërë i ekzekutueshëm. Ka shtuar se pretendimi i debitorit se nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt aktin administrativ është i pabazuar, sepse debitorit në bazë të dëshmisë së fletëkthesës nga PTK të datës 03.02.2021, është konfirmuar se debitori e ka pranuar Aktvendimin Nr.232 të datës 03.02.2021, ndaj të cilit nuk ka ushtruar ankesë në procedurës administrative. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe urdhri përmbareimor P.nr.168/2023 i datës 01.06.2023, të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaremore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbareues ka lejuar përmbareimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbareues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbareimin vetëm në bazë të dokumentit përmbareues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbareimor, përkatësisht Aktvendimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr.232 të datës 03.02.2021, në bazë të së cilit përmbareuesi privat ka lejuar përmbareimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbareues sipas të cilit mund të caktohet përmbareimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata gjeti se Aktvendimi Nr.232 i datës 03.02.2021, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbareimor është i përshtatshëm për përmbareim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit”,* pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi Nr.232 i datës 03.02.2021, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbareim, organit përmbareues i dorëzohet edhe dokumenti përmbareues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbareueshmëris për përmbareueshmëri”,* dhe paragrafin 2 të po të njëjtit neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbareueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”,* ngase Aktvendimi Nr.232 i datës 03.02.2021, i nxjerrë nga Komisioni i Pavarur për

Miniera dhe Minerale, është bërë i formës së prerë me datë 08.03.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 23.03.2021.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbare, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbaremit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.985/23, datë 20.09.2023

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.